

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI****VENDIM****Nr. 309, Datë 12.12.2025****MBI****MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË BORDIT TË ERE-S NR. 47
DATË 17.11.2025**

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe të nenit 5, pika 4, të Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 144, datë 30.09.2019, i ndryshuar me vendimin nr. 205, datë 30.09.2024; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 12.12.2025, pasi u njoh me përmbajtjen e procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më datë 17.11.2025, të përgatitur nga Sekretaria e Bordit,

Vendosi:

1. Miratimin e procesverbalit të Mbledhjes së bordit të ERE-s, nr. 47 datë 17.11.2025. (Procesverbali bashkëlidhur).
2. Procesverbali i miratuar sipas pikës 1 të këtij vendimi nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari i Bordit.
3. Ngarkohet për arkivimin e këtij vendimi dhe procesverbalit Sekretaria e Bordit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.